



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

K.DH.SH.II.nr.1412/22

Gjykata Komeriale - Dhoma e Shkalles se Dytë ne Prishtinë, me gjyqtaren Saranda Bogaj-Sheremeti, në çështjen përbarimore të kreditorit “...” me seli në Fushë Kosovë, të cilin e përfaqëson avokat Korab Rexhepi, ndaj debitorëve Qeveria e Republikës se Kosovës-Ministria e Shëndetësisë dhe Qendra Klinike Universitare e Kosovës –QKUK, me seli ne Prishtinë”, me bazë juridike përbarimore, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit Qendra Klinike Universitare e Kosovës – QKUK e parashtruar përmes përfaqësueses së saj T.I, kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, PPP.nr.714/2020, të datës 05.03.2021, me datë 07.10.2022, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e debitorit Qendra Klinike Universitare e Kosovës – QKUK, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, PPP.nr.714/2020, të datës 05.03.2021, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, me aktvendimin e atakuar PPP.nr.714/2020, të datës 05.03.2021, e ka refuzuar ne tërësi prapësimin e debitorëve Qeveria e Republikës se Kosovës-Ministria e Shëndetësisë dhe Qendra Klinike Universitare e Kosovës – QKUK, i ushtruar kundër Urdhrit Përbarimor P.nr.170/20, i datës 26.06.2020, të dhënë nga Përbaruesi privat Ilir Mulhaxha, i cili vepron në territorin e Gjykatës Themelore në Prishtinë

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë debitori i dytë Qendra Klinike Universitare e Kosovës-QKUK, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit te gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e shkallës së dytë, ta aprovoj këtë ankesë si të bazuar, aktvendimin e ankimuar ta ndryshoj dhe ta refuzoj kërkesëpadinë e paditësit .... si të pabazuar. Ndërsa debitori i parë nuk ka paraqitur ankesë edhe pse aktvendimin e datës 05.03.2021, e ka pranuar me datën 02.04.2021, çka vërtetohet përmes fletë kthesës që gjendet e bashkangjitur si provë në shkresat e lëndës.

Përgjigje në ankesë ka paraqitur kreditori përmes përfaqësuesit të tij Korab Rexhepi avokat, me arsyetimin se pretendimet e debitorit në ankesë nuk qëndrojnë dhe se theksimet e të njëjtit se nuk e ka pranuar aktgjykimin Ae.nr.93/19 dt.13.03.2020 nga Gjykata e Apelit, janë të paqëndrueshme sepse debitori i dytë si në prapësimin e ushtruar ndaj urdhrin përmbartimor është edhe në ankesë iu ka referuar po këtij vendimi, kjo tregon se debitori e ka pranuar vendimin dhe se aktgjykimi ka marrë formën e prerë dhe është i plotfuqishëm, kjo shihet edhe nga vula e plotfuqishmërisë, po ashtu duhet të theksojmë se lidhur me çështjen në fjalë ka vendosur edhe Gjykata Supreme me aktgjykimin nr. E.Rev.nr.63/20 dt.14.01.2020. Pra kemi të bëjmë me dokument përmbartues-titull ekzekutiv të plotfuqishëm, propozon që gjykata e shkallës së dytë ta refuzoj si të pabazuar ankesën debitorit të dytë dhe aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë ta vërtetoj.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimor si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e debitorit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori, ka paraqitur propozim për përmbartim ndaj debitorëve, në bazë të dokumentit përmbartues-Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike EK.nr.168/18, të datës 02.02.2019, i formës së prerë me aktvendimin e Gjykatës së Apelit në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike Ae.nr.93/19 të datës 13.03.2020 dhe i ekzekutueshëm nga data 16.06.2020.

Përmbartuesi Privat Ilir Mulhaxha me seli në Prishtinë, duke vepruar sipas propozimit për përmbartimin e kreditorit, me urdhrin përmbartimor P.nr.170/20, të datës 26.06.2020, e ka caktuar përmbartimin në bazë të dokumentit përmbartimor.

Debitori i dytë Klinika Universitare e Kosovës - QKUK, përmes përfaqësueses M.B me datë 08.07.2020, ka parashtruar prapësim, duke theksuar se nuk ka bazë që kreditori të kërkoj përmbartimin për arsye se debitori ende nuk e ka pranuar aktgjykimin Ae.nr.93/19 dt.13.03.2020 nga Gjykata e Apelit dhe deri sa nuk ka kaluar afati partitiv apo i përmbushjes vullnetare të detyrimit nga neni 24 par. 1 i LPP. Propozimin për përmbartim e kundërshton pasi ka bazë në kontratën e cila është nule në kuptim të nenit 89 të LMD dhe si e tillë nuk mund të prodhojë efekte juridike dhe se fitimi i llogaritur me këtë rast nuk është bërë për kreditorin .... por janë shfrytëzuar të dhënat nga gjendja e përgjithshme e tatimpaguesit “...” që është subjekt tatimpagues në raport me paditësin. Propozon që gjykata ta anuloj urdhrin për përmbartim P.nr. 170/20 dt.26.06.2020 si të pa bazë. Ndërsa debitori Qeveria e Republikës së Kosovës- i parë Ministria e Shëndetësisë, ka ushtruar prapësim me datën 03.07.2020, me pretendimin se të njëjtës i mungon legjitimiteti real

pasiv për te qenë palë ne procedurë. Nga përmbajtja e vendimit te Qeverisë nr.04/279 dt.07.11.2001 te nënshkruar nga Kryeministri i Kosovës, del se kemi te bëjmë me akt te përgjithshëm me te cilin rregullohet situata e përgjithshme objektive për te gjitha subjektet e jo akt individual me te cilin rregullohet ne çështjet konkrete. Gjykata e shkalles e parë dhe te dytë me rastin e marrjes se vendimeve me tepër i kanë kushtuar rendësi një kontrate te pavlefshme-nule se vendimit te Qeverisë se Kosovës. Propozon qe te miratohet prapësimi i debitorit, te shfuqizohet urdhri për përmbarrim dhe hiqen te gjitha veprimet e ndërmarra.

Përgjigje në prapësimet e ushtruara, ka parashtruar kreditori përmes përfaqësuesit te tij me datë 07.07.2020 dhe 10.07.2020, me të cilën ka theksuar se theksimet e debitorëve janë absolutisht te pabazuara dhe si te tilla kanë për qellim qe te zvarrisin procedurën. Theksimet e debitorit te parë-Qeveria e Republikës se Kosovës - Ministria e Shëndetësisë janë theksime qe nuk kanë te bëjnë me procedurën përmbarrimore por janë theksime qe janë pjesë e procedurës konestimore, ne rastin konkret kemi te bëjmë me përmbarrim ne bazë te vendimit te plotfuqishëm-titullit ekzekutiv qe është i ekzekutueshëm e jo me procedurë kontestimore. Arsyetimi i debitorit te parë për mos pagesë te borxhit –fitimit te humbur nga ana e kreditorit, me pretendimin se nuk ka legjitimitet real janë te pabazuara, ndërsa sa i përket theksimeve te debitorit te dytë –QKUK shton se pretendimet tij janë te paqëndrueshme sepse vet debitori i dytë ne vet prapësimin e ushtruar po i referohet aktgjykimit Ae.nr.93/19 dt.13.03.2020 qe do te thotë se ai e ka pranuar vendimin dhe se aktgjykimi ka marrë formën e prerë edhe është i plotfuqishëm gjë qe shihet nga vula e plotfuqishmërisë, theksimet se debitori i dytë QKUK do te shfrytëzoj mjetet e jashtëzakonshme, kanë për qellim vetëm ta zvarrisin procedurën por me nenin 69 te LPP përcaktohet se revizioni nuk është i lejuar ne procedurën përmbarrimore, andaj edhe propozon qe gjykata ti refuzoj prapësimet e debitorëve, ta lejoj vazhdimin e përmbarrimit duke e lënë urdhrin përmbarrimor ne fuqi dhe ta obligoj debitorin ti kompensoj te gjitha shpenzimet e shkaktuara ne procedurë.

Gjykata Themelore në Prishtinë, duke vendosur lidhur me prapësimet e debitorëve ka nxjerrë aktvendimin PPP.nr.714/2020, të datës 05.03.2020, me të cilin e ka refuzuar në tërësi si të pabazuar prapësimin e debitorëve duke vendosur si në dispozitiv të njëjtit. Në arsyetim të aktvendimit të atakuar gjykata ka theksuar se ka vlerësuar aktgjykimin e Gjykatës Themelore ne Prishtinë - Departamenti për Çështje Ekonomike EK.nr.168/2018 dt.02.02.2019, vërtetuar me aktgjykimin e Gjykatës se Apelit nr.Ae.nr.93/19 dt.13.03.2020 i plotfuqishëm me datën 13.03.2020 dhe i ekzekutueshëm nga data 16.06.2020 dhe është dokument përmbarrues me baze juridike për caktimin e përmbarrimit. Gjeti se pretendimet e debitorëve janë tërësisht te pabazuara dhe se te njëjtit nuk kanë paraqitur asnjë nga shkaqet për te cilat mund te paraqitet prapësimi, te paraparë me dispozitën e nenit 69 par.4 te LPP ngase pretendimi i debitorit ne lidhje me rregullsinë e marrjes se vendimit ne procedure kontestimore ne mes te palëve ndërjygyjëse nuk mund te jetë objekt shqyrtimi ne këtë procedurë. Debitorët nuk kane ofruar prova juridikisht te vlefshëm ne mbështetje

te pretendimeve te tyre te parapara me nenin 61 lidhur me nenin 69 par.4 dhe nuk janë përmbushur asnjë nga kushtet e parapara me nenin 71 par.1 pika 1 deri ne piken 12 te LPP.

Gjykata Komerciale –Dhoma e Shkallës e Dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka marr aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, i njëjti është i kuptueshëm dhe i qartë, prandaj vendimin e gjykatës, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Gjykata e shkallës e dytë, duke vlerësuar se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 1 dhe 2 të LPK-së dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Dhoma e Shkallës e dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë ka konstatuar drejtë faktin se aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike EK.nr.168/2018 dt.02.02.2018, është i formës së prerë me aktvendimin e Gjykatës së Apelit në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike Ae.nr.93/19 dt.13.03.2020, në rastin konkret është dokument përmbarues, konform nenit 22 paragrafi 1 pika 1.1 të LPP-së, e cila përcakton se: *“dokument përmbarimor është vendimi përmbarues i gjykatës dhe ujdia gjyqësore përmbaruese”* dhe përbënë bazën juridike për caktimin e përmbarimit sipas nenit 21, duke i plotësuar kushtet nga neni 24 dhe 27 paragrafi 1, i po këtij ligji ku përcaktohet se: *“dokumenti përmbarimor është i përshatshëm për përmbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit”*. Nga del se edhe kjo gjykatë pranon përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë se aktgjykimi EK.nr.168/2018 dt.02.02.2018 është vërtetuar me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit Ae.nr.93/19 dt.13.03.2020 dhe është i ekzekutueshëm nga data 16.06.2020, është dokument përmbarimor dhe përbën bazën juridike për përmbarim. Po ashtu vlerëson edhe faktin se edhe me aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës Rev.nr.63/2020 dt.14.01.2021 ka refuzuar revizionin e Ministrisë së Shëndetësisë e paraqitur ndaj aktgjykimit Ae.nr.19/19 dt.13.03.2020. Andaj edhe kjo gjykatë nuk ka pranuar pretendimet për gjendjen faktike sepse gjykata përmbarimore me saktësi ka konstatuar rrethanat mbi bazën e të cilave është lejuar përmbarimi përfshirë kushtet nga të cilat varet lejueshmëria e përmbarimit.

Dhoma e Shkallës e Dytë, sa i përket pretendimeve te debitori te dytë se nuk e ka pranuar ende aktgjykimin Ae.nr.93/19 dt.13.03.2020, dhe se i njëjti do te shfrytëzoj mjetet e jashtëzakonshme duke ushtruar Revizion, në situatën konkrete vlerëson se një mjet i tillë paraqitur nuk është pengesë për ekzekutimin e vendimit të formës së prerë, pasi që kjo shprehimisht parashihet me dispozitën e nenit 213 të LPK-së, përcaktohet se: *“Revizioni i paraqitur nuk është pengesë për përmbarimin e aktgjykimit të formës së prerë të goditur”*. Në kuptim të kësaj dispozite gjykata e shkallës së dytë vlerëson se revizioni i paraqitur nga i padituri/debitori nuk është pengesë për ekzekutimin e vendimit të formës së prerë dhe rrjedhimisht edhe në këtë drejtim rezultojnë si të

pathemelta pretendimet ankimore të debitorit të dytë –QKUK e te cilat kjo gjykatë i refuzoi si të pathemelta.

Në procedurën përmbaremore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përmbaremore i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përmbareures që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përmbareimin

Kompetenca e Gjykatës Komerciale –Dhoma e Shkalles e Dytë ne Prishtinë për te vendosur nga ana e gjyqtarit individual ne shkallë te dytë bazohet ne dispozitën e nenit 3 par.2 te LPP me te cilën është paraparë se ne shkallen e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga sa u tha me lartë në kuptim të nenit 209, par.1, pika b), të LPK-së e lidhur me nenin 17 të LPP u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE NE PRISHTINË  
DHOMA E SHKALLES SE DYTË  
K.DH.SH.II nr.1412/22, me datë 07.10.2022

Gjyqtarja  
Sarada Bogaj-Sheremeti